

URDHËR
Nr.28, datë 5.7.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR.6, DATË 25.11.2005 “PËR SEKUESTRIMIN E
ASETEVE TË SHTETASIT ABDUL LATIF SALEH, I NJOHUR EDHE SI: A) ABDYL LATIF
A.A. SALEH, B) ABDUL LATIF SALEH, C) DR. ABD AL-LATIF SALEH, D) ABDYL LATIF A.A.
SALEH ABU HUSSEIN, E) ABD AL-LATIF SALIH, F) ABU AMIR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.6, datë 25.11.2005 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

Në përmbajtjen e pikës 4 germa “a”, në fund të llogarive bankare të listuara në Bankën Ndërkombëtare Tregtare (Malajziane) shtohet llogaria me këtë përmbajtje:

llogari bankare shoqëria ose individ
000170 në USD Individ Abdyl Latif A.A. Saleh

Në përmbajtjen e pikës 4 germa “a”, në fund të llogarive bankare të listuara shtohen llogaritë në Bankën Raiffeisen me këtë përmbajtje:

- Llogaritë bankare ne Bankën Raiffeisen:

llogari bankare shoqëria ose individ

0100315426 në lekë “Foundation of Life and Science”

801015426 në euro Individ Abdyl Latif A.A. Saleh

2. Mbas pikës 7.4 shtohen pikat 7.5, 7.6, 7.7 me përmbajtjen si më poshtë:

7.5. Pasuria (apartament) me sipërfaqe 78 m² në zonën kadastrale 2315, volumi 8, faqe 236, numër pasurie 34/13+1-8 me adresë: Lagje nr.6, pallati 1, shkalla 1, kati 3, apartamenti 8, Kukës (indeksi i hartës KU-I-6).

7.6. Pasuria (truall) me sipërfaqe 98.9 m² në zonën kadastrale 2315, volumi 12, faqe 122, numër pasurie 39/55 me adresë: Lagje nr.3, pallati 23, apartamenti 1, Kukës. (indeksi i hartës KU-I-6).

7.7. Pasuria (apartament) me sipërfaqe 72.2 m² në zonën kadastrale 2315, volumi 8, faqe 146, numër pasurie 33/24+2-6, me adresë: Lagje 4, pallati 13, shkalla 2, kati 3, apartamenti 6, Kukës (indeksi i hartës KU-I-5).

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

4. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode